



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRI E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHBALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
SPECIALIST I SEKTORIT TË MONITORIMIT
DREJTORIA E INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Specialist i Sektorit të Monitorimit

Klasa e pagës: IV-1

Drejtoria: Drejtoria e Investimeve Strategjike

Raporton te: Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Roli i Specialistit në Sektorin One Stop Shop është të ofrojë mbështetje dhe ndihmë të specializuar për investitorët e mundshëm gjatë gjithë procesit të investimit.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Mbledhja e të dhënave përkatëse mbi aktivitetet investuese, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave nga sistemet e brendshme, burimet e jashtme dhe raportet e investimeve;
- Analizimi i të dhënave të investimeve për të vlerësuar performancën e portofolit, ekspozimin ndaj rrezikut dhe pajtueshmërinë me udhëzimet e investimeve;
- Ndjekja e performancës së portofoleve të investimeve kundrejt standardeve, objektivave dhe KPI-ve të vendosura;
- Monitorimi i treguesve kryesorë të performancës si kthimet, paqëndrueshmëria dhe tërheqjet për të vlerësuar shëndetin e portofolit;
- Monitorimi i rreziqeve të investimit, duke përfshirë identifikimin e faktorëve të mundshëm të rrezikut, vlerësimi i ekspozimit ndaj rrezikut;
- Monitorimi i përputhshmërisë me kërkesat rregullatore, politikat e investimeve dhe kontrollet e brendshme që rregullojnë aktivitetet e investimit;
- Gjenerimi i raporteve dhe përditësimeve të rregullta mbi performancën e investimeve, matjet e rrezikut dhe statusin e pajtueshmërisë;
- Pjesëmarrja në takimet e rishikimit të investimeve për të diskutuar performancën e portofolit, strategjitë e investimeve dhe iniciativat e menaxhimit të rrezikut;
- Sigurimi i të dhënave dhe analizave për të mbështetur proceset e vendimmarrjes gjatë këtyre takimeve;
- Kontribumi në përmirësimin e proceseve, metodologjive dhe mjeteve të monitorimit dhe vlerësimit;
- Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve efektive për të lehtësuar bashkëpunimin dhe koordinimin në përpjekjet monitoruese;

- Pjesëmarrja në aktivitete trajnimi dhe zhvillimi për të rritur njohuritë dhe aftësitë në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e investimeve.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDITATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi: Master shkencor në shkenca shoqërore. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e kërkuar.

Tjetër: Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(19.12.2025 afati i fundit i aplikimit)**.

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.

b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.